



NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE

Datë 15/04/2019

Në zbatim të Ligjit nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën nr. 469, datë 26.07.2018 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” konkursin për pozicionin:

Përgjegjës Sektori në Sektorin e Digjimit, Komunikimit dhe Projekteve pranë QBD-së

Kategoria e pagës për këtë pozicion është III-b.

Përshkrimi përgjithësues i punës për këtë pozicion:

1. Mbikëqyr përditësimin dhe publikimin e të dhënave dhe lajmeve në kohë reale në faqet e Internetit të institucionit;
2. Mbikëqyr hartimin dhe publikimin e librave elektronikë në faqen e QBD-së;
3. Bashkërendon me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse drejtimin dhe përpunimin e porosive elektronike për tekstet shkollore, librat digjitale dhe të digjituara, dhe materialet tjera të prodhuara nga QBD.
4. Nxit dhe bashkërendon veprimtaritë e QBD-së me njësitë tjera të institucionit si dhe me institucionet tjera që kanë lidhje me këto veprimtari; mban lidhje të drejtpërdrejta me drejtorin për të siguruar cilësi në punët që kryhen;
5. Harton dhe mbikëqyr veprimet për realizimin e veprimtarive të institucionit;
6. Vendos dhe mban lidhje me shoqatat, organizatat, qendrat, përfaqësitë brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë diasporën si objekt të veprimtarisë së tyre;
7. Ndjek dhe koordinon veprimtarinë e marrëdhënieve të QBD-së me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën, institucione analoge institucionet e tjera që kanë lidhje me këto aktivitete, organizata ndërkombëtare, të huaj si dhe me organizma shkencorë e punonjës të shkencës në viset shqiptare në rajon dhe në diasporë;
8. Në emër të QBD-së mban lidhje me përfaqësitë diplomatike shqiptare në vende të ndryshme;
9. Mban lidhje me sektorët përkatës të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
10. Ndjek hartimin dhe mbarëvajtjen e të gjitha projekteve të miratuara nga Këshilli Koordinues;
11. Bashkërendon përmbylljen e projekteve me kohë dhe brenda buxhetit. Cakton afate dhe përgjegjësi dhe mbikëqyr dhe harton raporte për mbarëvajtjen e tyre;



12. Bashkërendon dhe kryen përgatitjet e nevojshme në kuadër të projekteve të përbashkëta me Ministrin e Shtetit për Diasporën, për thirrjen e projekteve europiane, kombëtare dhe ndërkombëtare;
13. Raporton me shkrim mbi veprimtarinë vjetore, brenda përfundimit të vitit.
14. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Drejtori i QBD-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda objektivave të punës së tij.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:

Të jetë shtetas shqiptar;
Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

- a - Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Politike/ Sociale;
- b - Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- c - Njohuri të mira në një ose më shumë gjuhë të huaja;
- d - Përvojë pune në hartime dhe zbatime projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare;
- e - Aftësi drejtuese dhe organizative;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Jetëshkrimi CV;
Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.



Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 26/04/2019, në Zyrën e Protokollit të QBD-së pranë Kryeministrisë dhe në postën elektronike të QBD-së info@qbd.gov.al

Në datën 30/4/2019, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për të vijuar me testimin, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për tu futur në dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga QBD për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjin nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”;
- Njohuri mbi VKM nr. 469, date 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;
- Njohuri mbi ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006. “Për librin në Republikën e Shqipërisë”
- Njohuri mbi Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Botimeve për Diasporë (QBD) do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Diasporën,. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QBD-ja, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).